



INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS

02V- 103/25/1427

Republika e Kosovës / Republic of Kosovo	
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera / Ministry of Finance, Labour and Transfers	
Inspektorati Qendror i Punës / Centralna Inspektorat Rada / Central Labor Inspectorate	
Nr. Ab./No. 103/26	Nr.faq./Br. str./No. pg. 09
Data/Date 16.10.26	
MITROVICË / MITROVICA / MITROVICA	

Inspektoret e Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - të Inspektoratit Qendror të Punës, Divizioni në Rajonin e Mitrovicës, Inspektori [REDAKTUAR], të autorizuar me dispozitat e Nenit 83, 92 dhe 94 të Ligjit nr.03/L- 212 të Punës, dispozitës të nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr.03/L-017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, procesverbal të inspektimit me nr. 02-103/25/1427 të datës 25.11.2025, procesverbal të riinspektimit me nr. 02-103/25/1427A të datës 08.01.2026, më datën 16.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Personin [REDAKTUAR] me nr. personal [REDAKTUAR] i cili përfaqëson subjektin juridik "Klubi Hendbollistik Samadrexha Femrat" OJQ, me nr. 5114334-5 me seli në: fsh. Samadrexhë, Komuna e Vushtrrisë, me pronar [REDAKTUAR] (në tekstin në vijim punëdhënësi) konstatuam këtë gjendje faktike:

- Cenimin e dispozites ligjore te nenit 67, paragrafi 1, te Ligjit për të Huajt Nr. 04/L-219 i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 18 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të huajt e sanksionuar me nenin 132 paragrafi 1 i Ligjit për të huajt Nr. 04/L-219, I plotësuar dhe ndryshuar me nenin 47 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të huajt, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **NJË MIJË (1.000) Euro**
- Cenimin e dispozites së nenit 7 paragrafi 4, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.22 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **NJËQIND (100) Euro**

- Gjithsej ndaj subjektit juridik “Klubi Hendbollistik Samadrexha Femrat” OJQ, me nr. 5114334-5 me seli në: fsh. Samadrexhë, Komuna e Vushtrisë, me pronar [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] i shqiptohet Gjoha në lartësi prej Njëmijë e njëqind (1.100) Euro.

Dëftesa mbi pagesën e gjobës merrët në Inspektorat të Punës, adresa: Rr:“Afrim Zhitia” p.n. Mitrovicë, afati i pagesës 30 ditë.

Punëdhënësi duhet të dëshmoj pagesën e gjobës, duke dorëzuar një kopje të pagesës në zyrën e Inspektoratit të Punës, në Mitrovicë, rruga:“Afrim Zhitija”, (Ndërtesa e ish Administratës Pensionale), kati i III-të, zyrja nr.06, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbaruese tek organet kompetente.

A r s y e t i m

Me datën 28.10.2025, kemi pranuar informatën nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, lidhur me inspektimin që kanë kryer në Klubin e Hendbollit për Femra “Samadrexha”, me datë 16.10.2025. Gjatë inspektimit kanë gjetur dy shtetase nga Maqedonia e Veriut [REDAKTUAR] me nr. pas. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me nr. pas. [REDAKTUAR].

Më rastin e riinspektimit në subjektin e lartëcekur, në bazë të inspektimit të bërë me datë 25.11.2025, lidhur me parashtrësën me nr. prot. 415/25 të datës 28.10.2025, gjatë inspektimit kemi obliguar të prezentoj dokumentacionin nga marrdhënia e punës, ku brenda afatit të dhënë me procesverbal 02-103/25/1427 të dt. 25.11.2025, zyrtarët nga subjekti juridik kanë sjellë dokumentacionin e kërkuar në zyrët e Inspektoratit të Punës në Mitrovicë.

Punëdhënësit i është dhënë vërejtje në bazë të nenit 5.5 shkronja b) të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, që brenda afatit prej 05 ditësh, të prezentoj këto dokumentacione:

Brenda afatit ligjor subjekti juridik, ka sjellur ne zyret e Inspektoratit të Punës në Rajonin e Mitrovicës me postë dhe me email zyrtar, këtë dokumentacion të evidentuar më poshtë.

- Dosjen e punëtorëve të inspektuara, me të gjithë dokumentacionin nga marrdhënia e punës;
- Kontratat e punës, konform nenit 10 të Ligjit 03/L- 212 i Punës;

- Dëshmi nga administrata tatimore për pagesen e trustit pensional se është i lajmëruar në ATK, konform dispozitës së nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit 03/L-212 i Punës;
- Listën e pagave nga ATK;
- Listën e punëtorëve nga ATK;
- Lejen e punës për punëtoren [REDAKTUAR];
- Vendim për largim vullnetar për [REDAKTUAR];
- Vërtetim për pranimin e kërkesës për leje qëndrim të përkohshëm.

Nga lëmia e marrëdhënies së punës:

Punëdhënësi ka prezentuar dëshmitë se [REDAKTUAR] ka qenë e lajmëruar në (ATK), ndërsa në bazë të dëshmive të prezentuara [REDAKTUAR] nuk ka qenë e lajmëruar, konform nenit 7, par. 4 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës. Pra punëdhënësi ka cenuar dispozitën e nenit 7, par. 4 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka prezentuar kontratat e punëtorëve, i obliguar me dispozitën e nenit 10 dhe 11 i Ligji nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka sjellur listën e punëtorëve dhe listën e pagave të cilët janë duke punuar në subjektin juridik, i obliguar me nenin 57 të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka prezentuar lejen e punës për punëtoren [REDAKTUAR], e lëshuar me datën 09.10.2025, nga MPB. Ndërsa lidhur me punëtoren [REDAKTUAR], punëdhënësi ka prezentuar vërtetimin për pranimin e kërkesës për lejeqendrim, i datës 17.10.2025. Gjithashtu punëdhënësi ka prezentuar Vendimin për Largim Vullnetar lidhur me punëtoren [REDAKTUAR], i nxjerr nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, me datë 21.11.2025. Në arsyetim të vendimit ceket se punëtorja deklaron se: *“Në Kosovë ka ardhur për të luajtur Hendboll, dhe ka luajtur dy ndeshje zyrtare me Klubin e Hendbollit për femra “Samadrexha”, me të cilin ka kontratë nga data 11.09.2025”*. Andaj sa i përket punëtorese [REDAKTUAR] punëdhënësi ka bërë shkelje të nenit 67, paragrafi 1, të Ligjit 04/L-212 për të Hujat, ku përcaktohet se (citoj): *“1. I huaji në Republikën e Kosovës mund të punojë në bazë të lejes së dhënë për qëndrim dhe punë ose vërtetimit për lajmërimin e punës, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe;”*.


Andaj duke u bazuar nga të dhënat e cekura më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi është i obliguar, që në vazhdimësi të bëjë zbatimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, Ligji 03/L-212 të Punës dhe Ligjit 04/L- 161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, në të kundërten moszbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të merren si masë rëndësuese dhe do të cilësoheni si recidivist.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet subjektit “**Klubi Hendbollistik Samadrexha Femrat**” dhe kopjet tjera mbesin në Inspektoratin e Punës për procedura të mëtutjeshme.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave të MFPT-së, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Mitrovicë, Rruga: “Afrim Zhitia”, ish objekti i ndërtesës pensionale, kati i dytë, nr.34, Mitrovicë.

Data: 16.01.2026



Inspektorët e Punës

